

EPPC Albania kërkon një **Përfaqësues Shitjesh nga Zyra** për klientin e saj, i cili operon prej 25 vitesh në vend në sektorin e tregëtisë së materialeve elektrike, pajisjeve elektronike dhe telekomunikacionit.

Përgjegjësitë kryesore:

- Informon dhe prezanton tek klientët produktet dhe shërbimet që ofron kompania;
- Dërgon ofertat tek klientët sipas porosive përkatëse;
- Ofron një shërbim të shkëlqyer ndaj klientëve, duke u siguruar në përbushjen e të gjitha nevojave të tyre;
- Bashkëpunon me sektorë të tjerë brenda kompanisë për të mundur ekzekutimin me sukses të shitjeve bazuar në rregulloret dhe politikat e kompanisë;
- Ndjek dhe adreson në sektorët përkatës, ankesat e klientëve.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare, *preferohet Inxhinieri Elektrike*;
- **Eksperiencë pune e mëparshme në shitje ose shërbim klienti**, (*eksperienca në fushën e materialeve elektrike përbën avantazh*);
- Të zoterojë mirë gjuhën Angleze.
- Të njohë mirë Microsoft Office;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe shitjeje;
- Paraqitje profesionale dhe të jetë i/e orientuar drejt shërbimit të klientit;
- Të jetë i përgjegjshëm dhe të punojë nën presion.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutem dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.